



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 11215 Prot

Lezhë, më 14 / 06 /2022

VENDIM

Nr. 54, Datë 13 . 06 .2022

Për një ndryshim në VKB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1/b dhe pikën 4 të vendimit të KB nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Lezhë për vitin 2022”, si më poshtë:

1/1 -Në pikën 1/b “Plani shpenzimeve sipas programeve buxhetore” për vitin 2022 bëhet ndryshimi:

• Pakësohen :

-Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.600 në shumën 600,000 lekë dhe Art.601 në shumën 100,000 lekë.

-Gr.00, Prog.03140, Kap.01, Art.600 në shumën 200,000 lekë dhe Art.601 në shumën 33,000 lekë.

-Gr.00, Prog.03280, Kap.01, Art.600 në shumën 150,000 lekë dhe Art.601 në shumën 25,000 lekë.

-Gr.00, Prog.04220, Kap.01, Art.600 në shumën 300,000 lekë dhe Art.601 në shumën 50,000 lekë.

-Gr.00, Prog.06140, Kap.01, Art.600 në shumën 594,000 lekë dhe Art.601 në shumën 100,000 lekë.

-Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.600 në shumën 150,000 lekë dhe Art.601 në shumën 25,000 lekë.

• Shtohet : Gr.00, Prog.04760, Kap.01, Art.600 për shumën 1,994,000 lekë dhe Art.601 në shumën 333,000 lekë.

1/2 -Në pikën 4 “Miratimi i numrit të punonjësve sipas programit buxhetor” bëhet ky ndryshim :

• Shtohet numri i punonjësve në programin “04760” për 20 punonjës me kontratë 3 mujore.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ